



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2021:274224
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06246461

K.DH.Shk II.nr. 1335/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbartimore të kreditorit “NB COMPANY / NOTI BETON” SH.P.K., me NUI: 810727563, me seli në Fshatin Llazarevë, në Obiliq, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson avokati Gëzim Hoti dhe Pranvera Alshiqi – Maloku, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr. 656/22, të datës 10.06.2024, me datë **02.10.2024**, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr. 656/22, të datës 10.06.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 656/22, të datës 10.06.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.961/21 të datës 10.11.2021, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, duke lënë në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.961/21 i datës 10.11.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj. Ndërsa në pikën III të dispozitivit ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përfaqësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 270.40 € (dyqind e shtatëdhjetë euro e katërdhjetë cent) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozim që Gjykata e Shkallës së Dytë, të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr. 656/22, të datës 10.06.2024.

Kreditori nëpërmjet përgjigjes në ankesë ka kërkuar nga Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Dytë të refuzoj në tërësi si të pabazuar ankesën e debitorit ndërsa të lë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, KPPP.nr. 656/22, të datës 10.06.2024.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar urdhrin përmbarimor P.nr.961/21 të datës 10.11.2021, duke lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr. 10/2021 të datës 17.09.2021, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që t'ia paguajë kreditorit në emër të pjesës së mbetur të obligimit të papaguar sipas faturës së lartcekur shumën prej 13,978.22 €, me kamatë ligjore prej 8 %, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm dhe pasojave tjera ligjore, ashtu që përmbushja e detyrimeve të realizohet përmes llogarisë së debitorit në Ministrinë e Financave me transferimin e të hollave në llogarinë e kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor përmes përfaqësuesit të saj, ka kundërshtuar urdhrin përmbarimor duke theksuar ndër të tjerash se fatura e bashkëngjitur së bashku me propozim nuk është dokument përmbarues në bazë të cilës mund të ushtrohet përmbarimi, pasi që është e njëanshme dhe është nënshkruar vetëm nga ana e kreditorit dhe si e tillë nuk mund të ekzekutohet. Më tutje ka shtuar se në faturë nuk është theksuar afati kohor i pagesës si dhe nuk përmban elementet e domosdoshme ku përfshihet edhe arsyeja e faturimit, gjegjësisht përshkrimi i sasisë së mallrave ose shërbimeve të shitura. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet si i bazuar prapësimi i debitorit, të shfuqizohet urdhri për lejimin e përmbarimit dhe të abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e paraqitura të debitorit në prapësim, duke theksuar se të njëjtat kanë për qëllim vetëm prolongimin e pagesës së borxhit dhe se këto pretendimet nuk mbështeten në asnjë provë konkrete. Më tutje ka shtuar se fatura përbën dokument të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal si dhe është nënshkruar me vulë të protokollit nga debitori dhe atë me numër të protokollit 06-422/01-196737/21 të datës 17.09.2021. Në lidhje me pretendimet e

debitorit se nuk janë përshkruar sasia e mallrave dhe shërbimeve edhe ky fakt nuk qëndron, ngase në faturë shihet qartë përshkrimi për ofrim të shërbimeve për Ndërtim të Implantit e që kreditori i ka ofruar debitorit. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj në tërësi prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi dhe të detyrohet debitori që t'i paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr. 656/22, të datës 10.06.2024, ku në dispozitivin e aktvendimit ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.961/21 të datës 10.11.2021, të Përmbartuesit Privat Destan Bujupaj, duke lënë në fuqi Urdhri Përmbartimor P.nr.961/21 i datës 10.11.2021, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Destan Bujupaj. Ndërsa në pikën III të dispozitivit ka detyruar debitorin që në emër të shpenzimeve për përfaqësim, t'ia paguaj kreditorit shumën prej 270.40 € (dyqind e shtatëdhjetë euro e katërdhjetë cent) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se në rastin konkret Fatura Nr. 10/2021 e datës 17.09.2021, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim, i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të faturës të lëshuar nga kreditori, e cila faturë përmban elementet që kërkohen me nenin 29 paragrafi par.3 i cili përcakton se “*Dokumenti i besueshëm është i përshatshme për përmbartim po qe se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*”.

Gjykata e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim në pajtim me dispozitat ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe gjykata e shkallës së dytë, me çka mbi bazën e këtyre rrethanave dhe fakteve kësaj gjykatë i rezultoi se aktvendimi i ankimuar i nxjerrë nga gjykata e shkallës së parë është i drejtë dhe i bazuar.

Gjykata e shkallës së dytë bazuar në Udhëzimin administrativ Nr.15/2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, i cili në nenin 20 par.1 nenpar.1.17 parasheh që “*Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore*”, konsideron se fatura si dokument në sajë të cilës kreditori kërkon

përbushjen e detyrimit nga debitori, ka prova se është pranuar dhe nënshkruar nga debitori, prandaj konsiderohet si dokument i besueshëm. Po ashtu, fatura është dorëzuar në kopje të vërtetuar nga origjinali dhe mbanë nënshkrimin e pranimit nga ana e debitorit. Andaj, Fatura Nr. 10/2021 e datës 17.09.2021 është nënshkruar dhe e njëjta përmban vulën e protokollit nga debitori andaj, konsiderohet si pranim i rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se fatura nuk nuk përmban afatin e pagesës, por që këto pretendime i vlerësoj si të pabazuara, pasi që në vlerësimin e Gjykatës, afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë dhe e njëjta ka arritur afatin për përmbushje në datën e lëshimit, andaj me të drejtë ka vendosur gjykata e shkallës së parë.

Përndryshe në procedurën përbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkalles së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e shkallës së dytë
K.DH.SH.II nr.1335/24 me datë 02.10.2024

Gjyqtari
Faton Bajrami

Numri i lëndës: 2021:274224
Datë: 03.10.2024
Numri i dokumentit: 06246461